



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1284/16 prot.

Datë 02.06.2026

V E N D I M
Nr. 744/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 712/2025, datë 26.05.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Rej” SHPK me NIPT J93711608Q dhe adresë: Rruga Dritan Hoxha, Ngjitur me Shkollën Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 26.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 712/2026 ku vendosi:

1. *Të mbyll çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1844/18 prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1284/10 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.712/2026, datë 26.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1844/18 prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1284/10 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.712/2026, datë 26.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën, në përputhje me vendimin Nr.712/2026, datë 26.05.2026 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-82307-04-16-2026, me objekt: “Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec” me fond limit 108,236,213.88 lekë (pa tvsh), planifikuar për tu zhvilluar me datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro